



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1041 Prot.

Tiranë, më 20/9/2013

Lënda: Rekomandim për "Zyrë Përmbairimi Fabjo Isufaj", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 23, datë 20/09/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Zyrë Përmbairimi Fabjo Isufaj" Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale (nenet 5-9)
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe kofidencialiteti (nenet 27,28).
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21)

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Dosjet fizike të klientëve të tij mbahen në mënyrë manuale. Për sa i përket informimit ndaj klientit për qëllimin e përpunimit të të dhënave të tij kontrolluesi duhet të ketë një mënyrë të qartë dhe të shprehur për subjektet e të dhënave personale "kreditor" në lidhje me detyrimin për informim gjë e cila duhet të përfshihet në mënyrë të shprehur në kontratën e lidhur me kreditorin ose me anë të një akti informimi të veçantë në përputhje me kriteret e nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ku citohet shprehimisht se:

"kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij".

Gjithashtu u konstatua se nuk ka një rregullore të brendshme ku të jetë parashikuar mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë "klientë" në zbatim të nenit 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ku citohet shprehimisht se: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat

teknik-organizative të përshatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”

U konstatua gjithashtu se kontrolluesi “Zyrë Përbarimi Fabjo Isufaj” deri në momentin e dorëzimit të proces-verbalit nuk e kishte kryer detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Komisionerit, por dy ditë pas dorëzimit të proces-verbalit kontrolluesi e përmbushi detyrimin ligjor për të njoftuar dhe e ka depozituar Formularin e Njoftimit pranë zyrës së protokollit të KMDP-së.

Sistemi CCTV

Nga kontrolli administrativ u konstatua se kontrolluesi ka instaluar në ambientin e tij (zyrë) një sistem video-survejmimi të përbërë nga 1 kamer fikse në gjendje funksionale dhe një kompjuter për regjistrim imazhesh. Aksesin në këtë kompjuter e ka vetëm përgjegjësi i Zyrës. Në ambientin e brendshëm është e vendosur tabela informuese përkatëse. Qëllimi i vendosjes së kamerës sipas kontrolluesit është vetëm siguria e ambienteve të tij në rast tentative për vjedhje. U konstatua se përgjithësisht këtë sistem e aktivizon gjatë kohës që nuk ndodhet në zyrë dhe kjo rezultoi dhe nga këqyrja e çësjeve regjistrimeve. Regjistrimet ruhen në kompjuter brenda afatit kohor të përcaktuar në Udhëzimin Nr.3 Për "Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambiente të Ndryshme" (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 13, datë 22.12.2011).

Siguria ambienteve

Ambienti i kontrolluesit është i siguruar me sistem të brendshëm alarmi. Në rast të hapjes së paautorizuar të derës sistemi sinjalizon përgjegjësin e Zyrës nëpërmjet një thirrjeje në celularin e tij. Funkzioni i këtij sistemi u demonstrua dhe gjatë kontrollit.

U konstatua se kontrolluesi përdor kasafortë për të ruajtur dosjet me materialet përkatëse brenda nga zjarri apo vjedhjet. Në ambientet e kontrolluesit u evidentua dhe mbajtja e një grirëse letrash dhe bombol kundër zjarrit.

Sistemi ALBIS

Kontrolluesi regjistron dhe përpunon të dhëna personale në rrugë kompjuterike përmes sistemit Albis. ALBIS është Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përbarimit Gjyqësor Shqiptar. Ky ofron një menaxhimin të kompletuar të çështjeve përbarimore gjyqësore. Sipas përcaktimit në VKM Nr.443 datë 16.06.2011, Institucioni administrues i këtij sistemi është Ministria e Drejtësisë. Dhënës të informacionit në këtë sistem janë:

- i) Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit;
- ii) Zyrat vendore të përbarimit gjyqësor shtetëror nëpërmjet përbaruesve gjyqësorë shtetërorë;
- iii) Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- iv) Përbaruesit gjyqësorë privatë.

Në VKM-në e mësipërme përcaktohen dhe nivelet e aksesit në bazën e të dhënave për të gjithë kontrolluesit që veprojnë mbi këtë sistem.

Sistemi aksesohet përmes Internetit në adresën: <https://albis.justice.gov.al>

Hyrja në sistem realizohet duke plotësuar përdoruesin dhe fjalëkalimin. Sipas kontrolluesit, ky informacion i është komunikuar në mënyrë zyrtare nga Ministria Drejtësisë me një zarf të mbyllur. Pas aksesit fillestar, ky fjalëkalim mund të ndryshohet në çdo kohë nga vetë kontrolluesi.

Në modulën “Dokumentat” kontrolluesi mund të bashkëngjijë dokumentat e skanuar që kanë lidhje me një çështje (siç paraqitet në pamjen *printscreen* të programit të marr si shembull). Në këtë sistem kontrolluesi regjistron apo modifikon vetëm çështjet e kryera nga ai vetë, pra si masë sigurie aksesit i kufizuar garantohej plotësisht.

Nga karakteristikat e përshkruara të sistemit, modeli i paraqitjes së të dhënave në të dhe hierarkia e përdoruesve e përcaktuar në VKM Nr.443 datë 16.06.2011, sistemi përmbush kushtet për të garantuar sigurinë e të dhënave që ruhen dhe përpunohen përmes tij.

U konstatua gjithashtu se kontrolluesi “Zyrë Përmbairimi Fabjo Isufaj” deri në momentin e dorëzimit të proces-verbalit nuk e kishte kryer detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi nuk informon në mënyrë të qartë me anë të një akti subjektet e të dhënave “klientë” për qëllimin apo qëllimet e përpunimit, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- 2) Nga kontrolli administrativ i ushtruar u konstatua se kontrolluesi “Zyrë Përmbairimi Fabjo Isufaj” nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Të informohen në mënyrë të qartë, të plotë dhe të shprehur me anë të një akti subjektet e të dhënave “klientë” për qëllimin/met e përpunimit, për kategorinë e të dhënave që mbledhen dhe përpunohen, për personin apo personat që do të përpunojnë të dhënat, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat dhe të drejtat e subjektit për të patur akses apo për ti korigjuar ato, bazuar dhe në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
3. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e

denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

